

**Çka është
trashëgimia;
një koncept
jashtëtokësor?**

JP - EU/CoE Support to the
Promotion of Cultural Diversity (PCDK)

Funded
by the European Union





EUROPEAN UNION



COUNCIL OF EUROPE
CONSEIL DE L'EUROPE

Implemented
by the Council of Europe





JP - EU/CoE Support to the Promotion of Cultural Diversity (PCDK)

Funded
by the European Union



EUROPEAN UNION



COUNCIL
OF EUROPE
CONSEIL
DE L'EUROPE

Implemented
by the Council of Europe

SHTATOR, 2012

Ky dokument është prodhuar brenda kornizës së projektit të përbashkët 'BE/KE - Përkrahja për Promovimin e Diversitetit Kulturor në Kosovë*'. Përbajtja nuk reflekton domosdoshmërisht qëndrimin zyrtar të Bashkimit Evropian dhe/apo të Këshillit të Evropës.

* Ky shënim është pa paragjykim të qëndrimeve mbi statusin dhe është në përputhje me Rezolutën 1244 të KS të OKB-së dhe Opinionin e GJND-së për Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.

Parathënie

Këshilli i Evropës (KE) është një organizatë ndërqeveritare që ka qëllim të dyfishtë të promovimit dhe të mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe të garantimit të praktikave të proceseve demokratike në mbarë kontinentin e Evropës. Këto çështje vlejné për fushën e kulturës dhe të trashëgimisë kulturore, aq sa vlejné edhe për sektorët e tjerë të menaxhuar nga Këshilli i Evropës. Puna jonë shkon prej hartimit të politikave, të bazuara në standardet e dakorduara, dhe vazhdon me dhënien e përkrahjes dhe ndihmesës për qeveritë dhe partnerët e tjerë në zbatimin e politikave përmes instrumenteve dhe projekteve të ndryshme. Pavarësisht se sa e rëndësishme është kjo punë, qytetarët shpesh nuk e kuptojné atë plotësisht. Pyetja që shtrohet është se si t'ia shpjegojmë punën popullatës më të gjerë pa përdorur terminologjinë shumë teknike dhe shpesh të specializuar të fushës së të drejtave të njeriut dhe të trashëgimisë, të cilën shumë njerëz e konsiderojné si të pakuptueshme. Ne të gjithë jemi të sfiduar të gjejmë mënyra kreative për t'u ndërlidhur me palët e shumta me interes dhe për t'u treguar atyre rëndësinë e trashëgimisë kulturore të të gjitha komuniteteve.

Tregimi vizatimor (stripi), “Çka është trashëgimia; një koncept jashtëtokësor?” i krijuar përmes projektit të përbashkët të BE/KE-së – përkrahja për Promovimin e Diversitetit Kulturor në Kosovë (PDKK) është një tentim për ngritjen e vetëdijes lidhur me vlerën e trashëgimisë kulturore, i frymëzuar nga përmbajtja e dhënë nga kolegët tonë. Humori përdoret për të tërhequr vëmendjen e qytetarëve për çështjet e rëndësishme dhe për të angazhuar njerëzit e të gjitha moshave në shqyrtimin e një numri çështjesh relevante për trashëgiminë dhe diversitetin.

Përmes kësaj broshure tentohet të promovohet debati për të kuptuarit e trashëgimisë dhe diversitetit. E njëjta është hartuar në kontekstin e komponentit të arsimit dhe të ngritjes së vetëdijes së projektit të PDKK-së me qëllim të inkurajimit të dialogut, të të menduarit kreativ dhe të procesit dinamik të njohjes së përparësive të diversitetit. Personazhet e 'jashëtökësorëve' dhe nocioni i 'tehuajzimit' nga trashëgimia e vetvetes shpresojmë se do të hapin derën për diskutime të tjera.

Me zotimin e vazhdueshëm për ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe natyrore si mënyrë për kultivimin e parimeve bazë të të drejtave të njeriut dhe të demokracisë, Këshilli i Evropës mbetet i përkushtuar për avancimin e dialogut ndërkulturor dhe inkurajimin e përgjegjësisë kolektive të të gjithëve përkitazi me njohjen e vlerës thelbësore të trashëgimisë kulturore, si dhe të nevojës parësore për mirëkuptim të mirëfilltë dhe lartësim të dallimeve, duke përfshirë edhe njohjen e trashëgimisë së përbashkët që u përket të gjithëve.

Robert Palmer

Drejtor i qeverisjes demokratike, kulturës dhe diversitetit

Këshilli i Evropës

Parathënie

Trashëgimia kulturore njihet në mbarë Evropën si mekanizëm i identitetit kulturor. Mbrojtja e trashëgimisë sonë të përbashkët dhe promovimi i diversitetit kulturor janë po ashtu instrumente shumë të rëndësishëm për afrimin e komuniteteve të ndryshme dhe për përmirësimin e dialogut mes kulturave të ndryshme.

Se sa dinë njerëzit për trashëgiminë kulturore varet nga ajo se çka bëhet për promovimin e saj dhe nga kapaciteti i evropianëve për t'u familjarizuar me kulturën e tyre dhe kulturat e komuniteteve të tjera, si dhe për t'i vlerësuar ato.

Kjo është arsyeja pse njëri prej objektivave të Veprimit të përbashkët të Bashkimit Evropian/Këshillit të Evropës – përkrahja për Promovimin e Diversitetit Kulturor në Kosovë (PDKK)“ është rritja e vetëdijesimit të popullatës lidhur me rëndësinë e trashëgimisë kulturore si një e mirë e përbashkët dhe e pavarur nga çfarëdo konsideratë tjetër etnike a fetare.

Tregimi vizatimor (stripi) “Çka është trashëgimia; një koncept jashtëtokësor?” ilustron rëndësinë e trashëgimisë kulturore, duke paraqitur personazhe jashtëtokësore që flasin për karakteristikat e trashëgimisë tokësore. Ky tregim vizatimor na jep të kuptojmë se trashëgimia tokësore është trashëgimi e jona e përbashkët, për mbrojtjen e të cilës duhet t'i bashkojmë forcat dhe të punojmë së bashku.

Ruajtja dhe promovimi i diversitetit kulturor janë ndër parimet bazë të Bashkimit Evropian, dhe janë parim udhëzues për bashkëpunimin tonë me Kosovën. Duke promovuar mirëkuptim më të madh të rolit dhe rëndësisë së trashëgimisë kulturore, shpresoj se personazhet “jashtëtokësorë” nga ky tregim vizatimor në mënyrë argëtuese do të kontribuojnë në fuqizimin e dialogut mes komuniteteve të ndryshme dhe për nxitjen e procesit të pajtimit në një afat të gjatë.

Samuel Žbogar

Udhëheqës i Zyrës së BE-së/Përfaqësues special i BE-së

Hyrje

Komponenti i arsimit dhe i vetëdijesimit i Veprimit të përbashkët të Bashkimit Evropian / Këshillit të Evropës – përkrahje për Promovimin e Diversitetit Kulturor në Kosovë (PDKK) ka vënë kontakte me shkollat dhe me qytetarët përmes mekanizmave të ndryshëm të arsimit formal dhe joformal. Vetëdijesimi i qytetarëve lidhur me çështjet e rëndësishme për trashëgiminë dhe diversitetin është realizuar përmes publikimit të doracakut për mësimdhënësit e shkollave fillore, modulit universitar për trashëgiminë dhe diversitetin, sesioneve të dialogut dhe vizitave në terren të quajtura “Hajde!”.

Gjatë zbatimit të projektit të PDKK-së janë kërkuar në mënyrë aktive mënyrat për tërheqjen e vëmendjes së qytetarëve lidhur me çështjet e trashëgimisë dhe të diversitetit. Një nga këto përpjekje është paraqitur në këtë broshurë; këto tregime vizatimore (stripa) kanë për qëllim t'i japin shije dhe humor punës sonë, të cilat besojmë pasqyrojnë ironinë dhe ftesën për kreativitetet në këtë fushë. Tregimi vizatimor dhe personazhet e tij janë krijuar nga një kompani vendore e quajtur Trembelat, në bashkëpunim me ekipin e PDKK-së. Përmes çdo tregimi vizatimor tentohet të krijohet një ndjenjë humori ndaj çështjeve relevante për projektin e PDKK-së. Ne besojmë se humori është gjithmonë i dobishëm për të inkurajuar të menduarit kritik dhe për gjetjen e zgjidhjeve kreative. Shpresojmë se do të kënaqeni me ta.

Hakan Shearer Demir

Udhëheqës i ekipit të PDKK-së

Të gjithë jetojmë me qëllimin që të jemi të lumtur;
jetët tona janë të ndryshme dhe sërish aq të ngjashme.


(Anne Frank, shkrimtare dhe viktimë e Holokaustit)



Tjetri

A e përcakton kulturën urbane, fakti që një person jeton në qytet, përcakton identitetin e këtij personi deri në nivelin specifikisht urban? Identiteti i qytetit mbarë identitetin e atyre që jetojnë në të dhe e anasjelltas: ambienti urban reflekton nevojat dhe vlerat njerëzore.


(http://www.eki.ee/km/place/pdf/kp3_01_Haapala.pdf)



Identiteti urban

...trashëgimia kulturore jomateriale, e transmetuar nga gjenerata në gjeneratë, vazhdimisht rikrijohet nga komunitetet dhe grupet si reflektim ndaj ambientit të tyre, bashëveprimi të tyre me natyrën dhe historinë si dhe u siguron sensin e identitetit dhe vazhdimësisë duke promovuar në këtë mënyrë respektin për diversitetin kulturor e kreativitetin njerëzor.

(Article 2.1, Convention for the Safeguarding of the Intangible Cultural Heritage, UNESCO)



*GALAKSIA STRANGULA: QENDRA PËR STUDIME BLOYZPHLUGORE (BLOYZPHLUG QUHET ANTROPOLOGJIA NË PLANETIN E TYRE)

Trashëgimia kulturore jomateriale

Ngritja e shoqërisë industriale dhe rritja e prosperitetit e kanë kthyer turizmin në një aktivitet masiv për kohë të lirë dhe, në të njejtën kohë, individualizmi dhe postmodernizmi kanë kontribuar në krijimin e fragmentarizimit dhe llojlloshmërisë së kërkesave dhe ofertave turistike.

(Ndikimi i Rrugëve Kulturore Europiane në inovacionet dhe konkurrencën e NVM-ve)



Turizmi kulturor

Njerëzit janë emërues të përbashkët të përparimit.


(John Kenneth Galbraith, ekonomist dhe autor)



Zhvillimi ekonomik

Stereotipet ekzistojnë, por ne
duhet ti tejkalojmë.

(Forest Whitaker, aktor)



Stereotipet

Secili ka të drejtë që lirshëm të marrë pjesë në jetën kulturore të komunitetit, të kënaqet me artet dhe të përfitojë nga përparimi shkencor.

(Deklarata universale e të Drejtave të Njeriut, 1948, Artikulli 27)



Edukimi mbi trashëgiminë


...aspektet positive të globalizimit janë duke ua mundësuar kombeve dhe njerëzve që të pavarësohen politikisht, ekonomikisht dhe shoqërisht duke e bërë kështu luftën një opcion gjithnjë e më të papranueshëm.

(Muhamed El Baradej, diplomat egjiptian dhe drejtor gjeneral i Agjencisë Ndërkombëtare për energji atomike)



Globalizimi



Europa, një trashëgimi e përbashkët.



Ditët e trashëgimisë Europiane

Diversiteti është një e vërtetë e përbashkët
për ne të gjithë. Festojeni çdo ditë.

(Anonime)



Diversiteti


...trashëgimia arkitekture përbën një pasqyrim të pazëvendësueshëm të pasurisë dhe diversitetit të trashëgimisë kulturore të Europës, mbart dëshmi tejet të çmueshme mbi të kaluarën tonë dhe mbetet trashëgimi e përbashkët e të gjithë europianëve.

(Preambula e Konventës mbi mbrojtjen e trashëgimisë arkitekture të Europës, Granada, 1985)

ËJATË UDHËTIMIT TONË TË ARDHSHËM NE DO T'I VIZITOJMË OBJEKTET ARKITEKTURORE DHE KRYEVEPRAT TJERA ARTISTIKE QË NE, STRANGÛLONËT, I KEMI PUNUAR NË GJITHË GALAKSINË



NDALESA E PARË DO TË JETË TOKA, KU NE DO T'I VIZITOJMË DISA NGA VEPRAT MË TË MËDHA TË ARKITEKTIT TONË LENËZ, SIKUR MURIN KINEZ, PIRAMIDAT NË EGJPT DHE NË TË DY AMERIKAT - AI THJESHT E DONTË NDËRTIMIN E PIRAMIDAVE...



PASTAJ NE DO TË SHKOJMË NË EVROPË DHE TË SHOHIM "DARKËN E FUNDIT", "MONA LIZËN" DHE SHUMË PIKTURA DHE SKICA TJERA TË PUNUARA NGA ZAMLE ITILAH

PRIT! UNË KAM MENDUAR SE LEONARDO DA VINÇI I KA PUNUAR ATO?!




HAHAHA PO, AI ISHTE IDENTITETI TJETËR I TIJ. AI, GJITHASHTU, ISHTE NJË MJESHTËR I MASKIMIT. JU VËRTETË NUK KENI MENDUAR SE DA VINÇI ISHTE NJERI, APO JO?



Trashëgimia e përbashkët kulturore

Trashëgimia është pjesë e ADN-së sonë.
Ajo tregon kush ishim dhe kush jemi ne sot.

(Thorbjorn Jagland, Sekretar i përgjithshëm i Këshillit të Europës)



Rehabilitimi i trashëgimisë kulturore

Pejzazhi është gjithkund pjesë e rëndësishme e cilësisë së jetës së njerëzve.


(Preambula e Konventës europiane mbi pejzazhin, Firencë, 20 tetor 2000)



Trashëgimia natyrore

Qasja në trashëgiminë kulturore është e drejtë themelore që mundëson arritjen e vlerave demokratike, drejtësisë, stabilitetit e paqes si dhe përmirësimin e cilësisë së jetës sonë.

(Vizioni, Drejtorati për kulturë, trashëgimi kulturore e natyrore, Këshilli i Europës)



Kremtimi i trashëgimisë

